



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 14, datë 27.02.2025

**PËR
MIRATIMIN E EMËRIMIT TË PERSONELIT KYÇ TË DEPOZITARIT “FIRST
INVESTMENT BANK” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, Rregullores nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Rregullores nr. 1, datë 31.01.2024 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e emërimit të z. Erion Doko, si personel kyç, në pozicionin “Drejtor i Përputhshmërisë dhe Drejtor i Departamentit Ligjor” të Depozitarit “First Investment Bank” sh.a.**
- 2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**